



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

Lënda: **Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.**

Drejtuar: **Znj. Lindita NIKOLLA**
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “*Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*”, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

K R Y E T A R I

Enkelejd ALIBEAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2022

**PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES
VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, gërma “f”, 83, pika 1, dhe 108, pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë:

- a) bashki - 94
- b) qarqe - 12

2. Ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga ky ligj.

Neni 2

Emërtimi, shtrirja territoriale, kufijtë, qendra, njësitë administrative përbërëse të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe nënndarjet e tyre janë të përcaktuara në hartat dhe në tabelat bashkëlidhur këtij ligji dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

1. Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2019 dhe zgjedhjeve të pjesshme të vitit 2022, dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2023.

2. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.

3. Organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2023, do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4

Ligji nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA

Miratuar, më _____._____.2022